

**V E N D I M**  
**Nr.476, datë 4.9.1995**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.301, DATË 14.6.1993 “PËR MASAT PËR ZBATIMIN E LIGJIT “PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE ISH-PRONARËVE””**

Me propozimin e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I :**

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.301, datë 14.6.1993, bëhen këto ndryshime:

1. Pas shkronjës “ç” të pikës 1 shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“Kur çmohet se veprimëtaria e një ose disa komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve duhet të mbyllet para datës 31.12.1995, vendos mbylljen e veprimëtarisë së tyre dhe njoftonë për këtë organin përkatës të pushtetit lokal, këshillin e rrethit ose këshillin e bashkisë.

Çështjet e mbetura të patrajtuara nga komisioni, veprimëtaria e të cilit mbyllet para datës 31.12.1995, i kalojnë për shqyrtim e zgjidhje një komisioni tjetër homolog brenda të njëjtit rreth si njësi territoriale, i cili caktohet nga kryetari i Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve”.

2. Pas paragrafit të fundit të shkronjës “b” të pikës 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Sekretari i Shtetit për Pushtetin Lokal, në bashkëpunim me Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve kanë të drejtë të disponojnë fondin e pagave dhe organikën e lirë që rezultojnë nga mbyllja e veprimëtarisë së komisioneve të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve deri në datën 31.12.1995 dhe t’i kalojnë si shtesa në përbërjen e komisioneve të atyre bashkive a rretheve që çmohen se e kanë të nevojshme një shtesë të tillë për të përballuar në kohë vëllimin e punës së tyre për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**